



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikış - Dalëse - Izlazna - Outgoing	
02	No.Nr. 079-21
Tarih/Dt. 20.04.2021	



Referenca : 626/21/003/236

Në bazë të nenit 5 paragrafi 1 dhe nenit 108/A paragrafit 6 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe në bazë të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave të rregullores së Prokurimit Publik neni 4 pika b, nenin 7 paragrafi 7.1 pika a) bie këtë :

V E N D I M

I

Refuzohet si e jashtë afatshme kërkesa për Rishqyrtim e Operatorit Ekonomik - “DEA GROUP” SH.P.K- PRISHTINË e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës me datën 19.04.2021 në orën 16:24 për aktivitetin e prokurimit me nr. 626-21-1182-2-3-6 dhe nr. të brendshëm: 626-21-003-2-3-6 me titull “HARTIMI I PROJEKTEVE IDEORE DHE ATYRE KRYESORE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS PËR VITIN 2021”

II

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik “DEA GROUP” SH.P.K nga Prishtina më datën 19.04.2021 në orën 16:24 përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit të vendimit të Autoritetit Kontraktues, në të cilin njoftim është përcaktuar përfituesi i tenderit me titull: “HARTIMI I PROJEKTEVE IDEORE DHE ATYRE KRYESORE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS PËR VITIN 2021”.

Si autoritet kontraktues, pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, menjëherë kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor kemi filluar shqyrtimin e kërkesës për

rishqyrtim. Duke analizuar të njëjtën kemi vërejtur se kërkesa për rishqyrtim rezulton të jetë dorëzuar jashtë afatit të paraparë në nenin 4 pika b të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave të rregullores së Prokurimit Publik.

Zyra jonë me datë 14.04.2021 në platformën elektronike, ka publikuar njoftimin B58 mbi vendimin e Autoritetit kontraktues dhe letrat standarde. Sipas nenit 4 pika b të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave të rregullores së Prokurimit Publik, afati për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim është brenda 5 ditëve nga data e publikimit. Operatori Ekonomik e ka dorëzuar kërkesën në ditën e pestë pas publikimit të njoftimit B58 nga ana jonë, mirëpo e njëjta është dorëzuar jashtë orarit zyrtar, pra pas orës 16:00.

LPP në nenin 5 paragrafi 1 shprehimisht e ka paraparë që: **Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit.**

Pasi që data 19.04.2021 ka qenë dita e pestë dhe njëkohësisht dita e skadimit të afatit ligjor, kërkesa për rishqyrtim është dashur të dorëzohet deri në ora 16:00 ndërsa "DEA GROUP" SH.P.K kërkesën për rishqyrtim e ka dorëzuar në ora 16:24.

Ne si autoritet kontraktues nuk jemi lëshuar në shqyrtimin e përmbajtjes së ankesës, pasi që e njëjta është cilësuar si e jashtë afatshme dhe në përputhje me nenin 7 paragrafi 7.1 pika a) e njëjta duhet të refuzohet.

Andaj,

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në Mamushë, me dt. 20.04.2021

Gazmend Gashi

Udhëheqësi i sektorit të prokurimit

Komuna e Mamushës



Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.